



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

KA.nr. 83/22

GJYKATA KOMERCIALE, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, gjyqtari Arnis Dumani, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit Industria D... S.A., me seli në Spanjë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson avokate K.N.SH, me seli në Prishtinë, kundër të paditurit Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, me seli në Prishtinë, për shkak të anulimit të vendimit nr. 08/2018 të datës 05.11.2018, pas shqyrtimit kryesor publik të mbajtur me datë 13.10.2022, në prezencë të përfaqësueses së paditësit, me datë 21.10.2022 merr këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET në tërësi si e pa bazuar kërkesëpadia e paditësit Industria D... S.A., me të cilën ka kërkuar anulimin e vendimit me numër 08/2018 të datës 07.11.2018 i nxjerrë nga i padituri Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, dhe ti njihet e drejta e përparësisë nga IR754000 e vlefshme edhe në Serbi e datës 15.03.2001 për markën ‘G...’ apo çështja të kthehet tek i padituri për rivendosje.

A r s y e t i m

Paditësi Industria D... S.A. përmes përfaqësuesit me autorizim, ka parashtruar padi me kërkesë për anulimin e vendimit të Komisionit për shqyrtimin e ankesave pranë Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë nr. 08/2018 të datës 05.11.2018, me arsyetimin se paditësi ka aplikuar për regjistrimin e markës ‘G...’ me nr. 3457/2008 dhe ishte kërkuar njohja e të drejtës së përparësisë e datës 15.03.2001 e nxjerrë nga aplikimi ndërkombëtar IR754000, i cili është i shtrirë edhe në Serbi. I padituri me datë 20.06.2012 kishte njoftuar paditësin se duhet dorëzuar edhe listën e produkteve dhe shërbimeve, ndërsa me vendimin nr. 23531 të datës 29.09.2018, Agjencia e Pronësisë Industriale (API) ka regjistruar markën tregtare ‘G...’ dhe datë të regjistrimit ka shënuar datën 21.08.2012 kurse tek e drejta e përparësisë vendimi nuk thekson asgjë. Lidhur me këtë, paditësi pretendon se data e paraqitjes së aplikimit nuk është dashur të zhvendoset prej 15.10.2008 në 21.08.2012 për shkak se në kohën e paraqitjes së aplikacionit dispozitat të cilat kanë rregulluar procedurën dhe kushtet nuk kanë qenë të qarta

dhe neni 25 i ligjit në të cilin bazohet API duhet të interpretohet në lidhje me afatet e parapara në dispozitat e përgjithshme administrative për afatin brenda të cilit duhet të përfundohet një procedurë. Po ashtu lidhur me të drejtën e përparësisë ka theksuar se i padituri ka shkelur parimin e barazisë para ligjit dhe parimin e pritshmërisë legjitime pasi që paditësi me ankesë kishte bashkangjitur vendimin nr. 8767 i datës 04.01.2013 ku për rastin e njëjtë kishte pranuar të drejtën e përparësisë. Në seancën e shqyrtimit kryesorë dhe në fjalën përfundimtare ka qëndruar në tërësi pranë pretendimeve në padi dhe ka shtuar se vendimi i cili kontestohet me padi vetëm ka përshkruar rrjedhën e procedurës prej aplikimit deri në regjistrimin e markës dhe nuk është përgjigjur në pretendimet e paditësit të paraqitura në ankesë dhe se nga provat e administruara vërtetohen pretendimet e paditësit si të bazuara, andaj gjykatës i ka propozuar që të aprovohet në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësit.

I padituri me përgjigje në padi e ka kontestuar në tërësi padinë e paditësit duke theksuar se vendimi i të paditurës është marrë konform dispozitave ligjore në fuqi dhe nuk qëndrojnë pretendimet e paditësit se vendimi është marrë me shkelje ligjore dhe se këto pretendimet nuk i ka vërtetuar me asnjë provë, prandaj gjykatës i ka propozuar që të refuzohet në tërësi kërkesëpadia e paditësit dhe të mbetet në fuqi vendimi i të paditurës. Në seancën e shqyrtimit kryesorë nuk ka prezantuar edhe pse ka qenë i ftuar në mënyrë të rregullt, andaj gjykata shqyrtimin kryesor të çështjes e ka mbajtur në mungesë të palës së paditur në kuptim të nenit 41 të Ligjit për Konfliktet Administrative.

Gjykata me qëllim të vlerësimit të ligjshmërisë së vendimit kontestues dhe vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, në seancën e shqyrtimit kryesor ka administruar këto prova: Aplikacioni për regjistrimin e markës tregtare nr.3457 datë 15.10.2008; Fletëpagesa me nr.5809 e datës 22.08.2012; Kërkesë për plotësimin e aplikacionit të markave tregtare në bazë të njoftimit e datës 28.02.2012; Certifikatë për marke tregtare nr. KS/8342 e datës 27.09.2018; Vendim për regjistrimin e markës tregtare nr. 23531 i datë 27.09.2018; Ankesë e datës 16.10.2018; Vendim nr. 8/2018 i datës 05.11.2018; Vendim për regjistrimin e markës tregtare nr. 23523 i datës 27.09.2018; Certifikatë për markë tregtare nr. 23523 e datës 27.09.2018; Aplikacion për regjistrimin e markës tregtare nr.3590 i datës 15.10.2008; Vendim për regjistrimin e markës tregtare nr. 23529 i datës 27.09.2015; Certifikatë për markë tregtare nr. 23529 e datës 27.09.2018; Aplikacion për regjistrimin e markës tregtare nr. 3592 i datës 15.10.2008; Vendim për regjistrimin e markës tregtare nr. 23537 i datës 28.09.2018; Certifikatë për regjistrimin e markës tregtare nr. 23537 e datës 28.09.2018; Aplikacion për regjistrimin e markës tregtare nr. 3597 i datës 15.10.2008; Vendim për regjistrimin e markës tregtare nr. 23599 i datës 26.10.2018; Certifikatë për markë tregtare nr.23599 e datës

26.10.2018; Aplikacion për regjistrimin e markës tregtare nr. 3997 i datës 15.10.2008; Vendim për regjistrimin e markës tregtare nr. 23523 i datës 27.09.2018; Certificate për markë tregtare nr. 23523 e datës 27.09.2018; Aplikacion për regjistrim të markës tregtare nr.3589 i datë 15.10.2008; Vendim për regjistrimin e markës tregtare nr. 8767 i datës 04.01.2013; Aplikacion për regjistrimin e markës tregtare nr. 1298 i datës 18.07.2008; Ftesë për pagesën e regjistrimit për aplikacionin KS/2008/3457; Njoftim për plotësim të elementeve formale të kërkesës nr. prot. 4154 i datës 31.05.2012 për aplikacionin KS/M/2008/3457; Ekstrakti i nxjerrë nga databaza zyrtare e Organizatës Botërore për Pronësi Intelektuale përkatësisht Webfaqes ....

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues në përputhje me nenin 41 dhe 44 të LKA-së, provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor, pretendimeve të përfaqësueses së paditësit në seancë, thënieve në padi dhe përgjigjen në padi të paditurit si dhe pas shqyrtimit të gjitha shkresave tjera të lëndës gjeti se kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar.

Gjykata konstatoi se paditësi me vendimin nr. 23531 të datës 27.09.2018 kishte bërë regjistrimin e markës tregtare G...’ duke filluar nga data 21.08.2012 dhe vlefshmëri deri 21.08.2022, ndërsa tek e drejta e përparësisë nuk kishte paraqitur asnjë shënim.

Kundër këtij vendimi, përfaqësuesja e paditësit me datë 16.10.2018 kishte parashtruar ankesë pranë Komisionit të Ankesave në Agjencinë për Pronësi Industriale lidhur me zhvendosjen e datës së aplikimit si dhe mos njohjen e të drejtës së përparësisë së pretenduar nga paditësi.

Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave pranë Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë me datë 05.11.2018 me vendimin nr. 08/2018 ka refuzuar ankesën e paditësit dhe ka lënë në fuqi vendimin e API-së, nr. 23531 të datës 27.09.2018.

Paditësi i pakënaqur me këtë vendim, ka ushtruar padi në gjykatë, duke e kontestuar ligjshmërinë e të njëjtit.

Gjykata, shqyrtoi ligjshmërinë e vendimit të goditur me padi në kuptim të nenit 90 par. 4 të Ligjit Nr. 04/L-026 për Markat Tregtare i cili përcakton: “4. Kundër vendimit të komisionit mund të parashtrohet padi në Gjykatën kompetente në afat prej tridhjetë (30) ditësh.” dhe në kuptim të nenit 9 të Ligjit për Konfliktet Administrative i cili përcakton se: “Gjykata në konfliktin administrativ vendos për ligjshmërinë e akteve përfundimtare administrative, me të cilat organet e administratës, në ushtrimin e autorizimeve publike, vendosin për të drejtat, detyrimet dhe interesat juridike të personave fizikë dhe juridikë në çështjet administrative.”

Gjykata i vlerësoi të pabazuara pretendimet e paditësit sepse të njëjtat janë në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi për rastin konkret dhe me provat e administruara në shqyrtim kryesor.

Nga prova aplikacioni për regjistrimin e markës tregtare nr.3457 datë 15.10.2008, gjykata ka konstatuar se paditësi me datë 15.10.2008 pranë Zyrës për Pronësi Industriale ka aplikuar për regjistrimin e markës tregtare ‘G...’ dhe po ashtu kishte kërkuar njohjen e të drejtës së përparësisë, datën 15.03.2001 e nxjerrë nga aplikimi ndërkombëtar .... . Aplikacionit i kishte bashkangjitur dëshminë për të drejtën e përparësisë dhe dëshminë për pagesën e taksës administrative.

Nga prova njoftim për plotësim të elementeve formale të kërkesës nr. prot. 4154 i datës 31.05.2012 për aplikacionin KS/M/2008/3457, gjykata ka konstatuar se i padituri kishte kërkuar nga paditësi që të bëhet plotësimi i aplikacionit për regjistrimin e markës tregtare ‘G...’, aplikacioni KS/M/2008/3457, ashtu që të dorëzohet lista e produkteve dhe shërbimeve dhe taksa e depozitimit të aplikimit, përfshirë edhe taksën për prioritetin e pretenduar nr. IR754000.

Nga provat kërkesë për plotësimin e aplikacionit të markave tregtare dhe fletëpagesa me nr.5809 e datës 22.08.2012, gjykata ka konstatuar se paditësi me datë 21.08.2018 ka dorëzuar tek i padituri listën e shërbimeve dhe fletëpagesën e taksës për aplikacionin KS/M/2008/3457 sipas njoftimit të paditurit.

Nga prova Certifikatë për marke tregtare nr. KS/2018/8342 e datës 27.09.2018 dhe prova Vendim për regjistrimin e markës tregtare nr. 23531 i datë 27.09.2018, gjykata ka konstatuar se i padituri ka bërë regjistrimin e markës tregtare ‘G...’ sipas aplikimit dhe plotësimit të aplikimit ashtu që markën tregtare e ka regjistruar nga data 21.08.2012 si datë e dorëzimit të plotësimit të aplikacionit, ndërsa tek rubrika e të drejtës së përparësisë nuk ka bërë asnjë shënim, përkatësisht nuk i ka njohur të drejtën e përparësisë së pretenduar.

Nga prova ekstrakti i nxjerrë nga databaza zyrtare e Organizatës Botërore për Pronësi Intelektuale përkatësisht webfaqes ....., gjykata ka konstatuar se paditësi ka bërë regjistrimin e markës tregtare ‘G...’ duke filluar nga data 15.03.2001 e vlefshme deri me datë 15.03.2011 regjistrim ky që vlente edhe në Serbi.

Gjykata vlerëson se nga provat e administruara ka rezultuar se i padituri ka vepruar drejtë kur ka refuzuar ankesën e paditësit për zhvendosjen e datës së aplikimit nga data 21.08.2012 në 15.10.2008 si dhe për njohjen e të drejtës së përparësisë për shkak se paditësi nuk ka aplikuar

brenda afatit prej 12 muajve nga dita e hyrjes në fuqi të Udhëzimit Administrativ nr. 2007/06 për Organizimin dhe Funksionimin e Zyrës për Pronësi Industriale.

Fillimisht, gjatë vlerësimit të pretendimeve të paditësit për zhvendosjen e datës së regjistrimit të markës tregtare gjykata konstatoi se me nenin 30 par.4 të Ligjit Nr. 04/L-026 është përcaktuar se: *“4. Nëse mangësitë apo mos pagesat e përcaktuara në pajtim me nënparagrafët 1.1. dhe 1.3. të paragrafit 1. të këtij neni, nuk evitohen në përputhje me kërkesën e Zyrës apo nëse nuk evitohen brenda afatit të caktuar, aplikimi për regjistrimin e markës tregtare nuk do merret në konsiderim. Nëse aplikuesi plotëson aplikacionin sipas kërkesës së Zyrës, atëherë Zyra regjistron si datë të paraqitjes së aplikimit datën në të cilën plotësohen mangësitë.”*

Ndërlidhur me këtë, nga provat njoftim për plotësim të elementeve formale dhe kërkesë për plotësimin e aplikacionit, gjykata konstatoi se paditësi duke vepruar sipas kërkesës së të paditurit, me datë 21.08.2012 ka bërë plotësimin e aplikacionit me listën e shërbimeve dhe fletëpagesën e taksës, ashtu në përputhje me dispozitën e lartcekur, datë e paraqitjes së aplikimit duhet të merret data 21.08.2012 si datë në të cilën janë plotësuar mangësitë nga paditësi.

Lidhur me pretendimet e paditësit për njohjen e të drejtës së përparësisë, gjykata konstaton se Ligji nr. 02/L-54 për Markat Tregtare (ligj i aplikueshëm në kohën e paraqitjes së aplikacionit nga paditësi), në nenin 36 par.1 ka përcaktuar: *“36.1. Personi që ka bërë dorëzimin e rregullt të aplikacionit për markë tregtare në një vend që mbulohet me Konventë (këtu e tutje, kërkesat nga vendet nënshkruese të Konventës), kanë të drejtë përparësie për regjistrimin e të njëjtës markë tregtare për mallrat dhe shërbimet e njëjta sipas këtij ligj, për një periudhë gjathtë mujore që nga data e paraqitjes së kërkesës së parë nga vendi nënshkrues i Konventës.”* dhe në par. 2 ka përcaktuar: *“36.2. Nëse kërkesa për regjistrim sipas këtij ligji bëhet brenda periudhës së përcaktuar në nenin 36.1 të këtij ligji: a. data vendimtare për qëllime të përcaktimit të përparësisë është data e paraqitjes së kërkesës së parë nga një vend nënshkrues i konventës ...”* Me Udhëzimin Administrativ nr. 2007/06 për Organizimin dhe Funksionimin e Zyrës për Pronësi Industriale (më tutje referuar si: UA nr. 2007/06) është rregulluar organizimi dhe funksionimi i Zyrës për Pronësi Industriale në kuadër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë. Ndërsa në nenin 2 të Udhëzimit Administrativ nr. 2007/14 për Aplikimet e patentave, markave tregtare, dizajneve industriale, patentave të lëshuara, markave tregtare dhe dizajneve industriale të njohura para hyrjes në fuqi të këtij ua (më tutje referuar si: UA nr. 2007/14), është përcaktuar se: *“Personi që deri me datën e hyrjes në fuqi*

të UA Nr 2007/6 të datës 01.10.2007, është pronar i një objekti të pronësisë industriale së mbrojtur në ish RFJ, mund në një afat prej 12 muajsh nga kjo datë të dorëzoj një kërkesë në Zyre për regjistrim në regjistrat përkatëse të objekteve të pronësisë industriale.” Përfundimisht gjykata konstaton se me Ligjin nr. 04/L-026 për Markat Tregtare (në fuqi në kohën e shqyrtimit të aplikacionit dhe nxjerrjes së vendimit kontestues) në nenin 28 është përcaktuar: “1. Nëse aplikuesi për regjistrimin e markës tregtare ka paraqitur kërkesë për regjistrim të markës tregtare në formë të rregullt në Republikën e Kosovës, nga ndonjë shtet që është palë në Konventën e Parisit apo Marrëveshjen për themelimin e Organizatës Botërore të Tregtisë, për të njëjtën markë tregtare me mallrat apo shërbime që janë identike apo që i përmbajnë ato për të cilat është paraqitur aplikimi, ai mundet të thirret në të drejtën e përparësisë së paraqitjes së aplikimit të parë, me kusht që ai të aplikoj për regjistrim të markës tregtare në Republikën e Kosovës brenda gjashtë (6) muajsh nga data e paraqitjes së aplikimit të parë.”

Prandaj, nga vlerësimi i dispozitave të lartcekura dhe provave të administruara, gjykata konstaton se paditësi nuk ka përmbushur asnjërin kriter kohor për njohjen e të drejtës së përparësisë me aplikimin për regjistrimin e markës tregtare ‘G...’. Gjykata erdhi deri tek ky konstatim edhe duke interpretuar dispozitat e lartcekura në favor të paditësi pasi që afati prej 12 muajve i përcaktuar në UA nr. 2007/14 është afat në kundërshtim me afatin prej 6 muajve të përcaktuar në Ligjin nr. 02/L-54 për Markat Tregtare, por edhe në këtë rast, gjykata konstatoi se paditësi ka aplikuar pas kalimit të këtij afati.

Nga prova aplikacion për regjistrimin e markës tregtare, gjykata konstatoi se paditësi me datë 15.10.2008 ka aplikuar për regjistrimin e markës tregtare ‘G...’ më të cilin aplikacion ka kërkuar edhe të drejtën e përparësisë nga marka tregtare nr. IR 754000 e datës 15.03.2001, por që gjykata vlerëson se e drejta e përparësisë sipas nenit 2 të UA nr. 2007/6 ka mundur të kërkohet vetëm deri me datë 01.10.2008 andaj në këtë rast i padituri ka vepruar drejtë kur ka refuzuar ankesën e paditësit edhe për këtë pretendim.

Gjykata po ashtu ka vlerësuar edhe provat tjera të propozuara nga paditësi dhe të cilat janë administruar në shqyrtimin kryesor lidhur me pretendimet e paditësit për shkelje të parimit të pritshmërisë legjitime, përkatësisht provat që kanë të bëjnë me regjistrimin e markave tregtare nr. 23523 e datës 27.09.2018, nr. 23529 e datës 27.09.2015; nr. 23537 e datës 28.09.2018; nr. 23599 e datës 26.10.2018; nr. 23523 e datës 27.09.2018; nr. 8767 e datës 04.01.2013 e në të cilat aplikime, i padituri i ka njohur të drejtën e përparësisë paditësit edhe pse të gjitha aplikimet janë bërë me datë 15.10.2008, por megjithatë, gjykata vlerëson se

aplikimi i parimit të pritsmërisë së ligjshme dhe të arsyeshme nga neni 8 i LPPA-së nuk mund të bëhet në shkelje të dispozitave ligjore të cilat rregullojnë çështjen e afatit për njohjen e të drejtës së përparësisë në një markë tregtare, pra një parim i tillë mund të aplikohet në rastet kur bie në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi.

Prandaj, gjykata përfundimisht vlerëson se i padituri me rastin e refuzimit të ankesës së paditësit në procedurë administrative, ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe ka zbatuar dispozitat e Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative si dhe dispozitat tjera materiale të cituara më lartë.

Andaj, bazuar në nenet 13, par. 1, nën par. 1.12 lidhur me par. 5 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale dhe nenin 46 të Ligjit për Konfliktet Administrative, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE, Dhomat e Shkallës së Parë

Departamenti për Çështje Administrative

KA.nr.83/22, datë 21.10.2022

Gjyqtari

Arnis Dumani

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 7 (shtatë) ditëve, nga dita e pranimit të aktgjykimit, në Dhomën e Shkallës së Dytë në Gjykatën Komerciale, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.